

Viti XI, numri 5/maj 2007



FOREVER

HUNGARY / ALBANIA / BOSNIA AND HERZEGOVINA / CROATIA / KOSOVO / MONTENEGRO / SERBIA / SLOVENIA



FOREVER

TOP EUROPEAN COUNTRY APRIL 13 - 14 2007
STOCKHOLM, SWEDEN

#2 in European Sales

Congratulations and thank you to all the great distributors of

HUNGARY
(BOSNIA & HERZEGOVINA, CROATIA,
MONTENEGRO, SERBIA, SLOVENIA)

April 13, 2007



Gëzim për jetën

Po afrohet vera! Koha është sa vjen e më e mirë, dhe Forever lulëzon gjithashtu. Në pjesë e parë të këtij viti moti theu rekorde të papara ndonjëherë. E di që moti në këtë periudhë nuk është i tillë në çdo pjesë të botës, por këtu në Arizonë niveli i termometrit ngrihet nga dita në ditë.

Është një kënaqësi e madhe të shikosh kudo gjethet e gjelbëra dhe sythet e reja. Në pronën Maughan dalëngadalë fillojnë të dalin viçat dhe mëzat e sapolindur. Është bukur të shikosh hapat e tyre të para të pasigurta, pastaj disa orë më vonë duke u hedhur dhe vrapuar në livadh. Energjia dhe gëzimi i tyre për jetën i ngjitet kujdo brenda një momenti!

Ndonjëherë më shkon ndër mend që a i ngjitet mjedisit tonë energjia dhe gëzimi ynë për jetën. A dimë t'i gëzohemi me të vërtetë jetës, faktit që mund të ngrihemi çdo mëngjes, edhe nëse nuk niset çdo mëngjes me të njëjtin dinamizëm.

E kemi dëgjuar shpeshherë shprehjen: "Ti vetë bëhu përfaqësuesi më i mirë i produkteve" kur flasim rreth konsumimit të produkteve Forever. Por mendoj se ka raste që e harrojmë produktin kryesor të Forever-it, Planin Marketing! Që këtej e tutje, kur të dëgjojmë këtë shprehje,

ta mendojmë deri në fund: "Me të vërtetë e përfaqësoj shpresën dhe mundësinë që ofron Plani Marketing? Punoj dhe marr në mënyrën e duhur pjesën që ofron Plani Marketing? Ua tregoj me të vërtetë gjithë njerëzve që më rrethojnë se përse bën fjalë kjo mundësi?" Dhe në radhë të parë ta pyesim vetveten që: "I jap një shembull pozitiv dhe optimist skuadrës sime?"

Helen Keller, shkrimtarja dhe mësuesja e shkëlqyer amerikane, e cila jetoi e verbër dhe e shurdhër, rreth suksesit dhe optimizmit fliste kështu: "Optimizmi është qëndrimi plot besim, i cili të çon drejt rezultatit. Pa shpresë dhe besim nuk do të arrinim dot asgjë."

Të shmangemi nga rrezja e veprimt të ankesave, lajmeve të këqija dhe bisedave negative – edhe biznesi ynë nuk është i përsosur, siç nuk mund të jetë asgjë i tillë. Por është shumë e madhe mundësia që përfaqësojmë me drejtuesit tanë të shkëlqyer, me parimet tona të ndershme dhe familjen e mrekullueshme të produkteve tona. Të kemi besim në aftësitë tona, pastaj edhe të tjerëve do t'u ngjitet forca e madhe e përpjekjes për përsosmëri. Shfrytëzoheni me guxim dhe bindje këtë mundësi, kështu do të bëhet FOREVER me të vërtetë ekperienca më e madhe që shkakton gëzim për jetën!

Koha – 10 vjet

Pas disa orësh nisemi për në Stockholm, skuadra jonë e Forever-it do të vizitojë një nga kryeqytetet më të bukura të Europës. Prej vitesh të tëra është një nga aktivitetet më të mëdha të Europës ky ku tani po përgatitemi të shkojmë me më shumë se një mijë pjesëmarrës. Në kryeqytetin e suedezëve do të shkojë një nga delegacionet më të mëdha të Europës, dhe jam i sigurt se do t'i ngrohim rrugët e ftohta skandinave. Kur Ju e mbani në dorë dhe e lexoni këtë revistë bashkëpunonjësit e rrjetit tonë bisedojnë rreth rezultateve skandinave, të gjithë i përmendin si kujtime të bukura, dhe secili mendon rreth Ditës së Suksesit të përvjetorit të 10-të. Ngjarjet na bëjnë për vete, marrim pjesë vazhdimisht nëpër aktivitete, nuk e vemë re se si kalon dita, si fluturojnë sekondat dhe minutat. Ju si i përjetoni sekondat tuaja, e ndjeni mirë veten aty ku ndodheni tani? Nga momenti në moment tek shumë prej nesh shtrohet pyetja që a jetojmë jetën e duhur dhe në vendin e duhur? A ka vlera ajo që bëjmë, dhe a japim njohuri me veprimtarinë tonë? A janë të dobishme orët e kaluara, apo i bie vlera minutave dhe orëve?

Koha, koha, koha... Koha është një thesar i madh, duhet të mësojmë ta shfrytësojmë me zgjuarsi atë. Shfrytëzimi i kohës është një nga pikat bazë të sistemit Multi Level Marketing, e cila mësohet dhe edukohet nga specialistë të shumtë.

Për secilin do të thotë diçka tjetër të jetosh në mënyrë të dobishme, për secilin do të thotë diçka tjetër të jetosh mirë,

dhe ndërkohë koha kalon. Kalon një vit, dy vjet, **10 VJET...** E keni studiuar se sa në mënyrë të dobishme jetoni? Me atë që bëni a ndihmoni familjen, fëmijët, të njohurit dhe të afërmit tuaj? A mund të ndihmoni me veprimtarinë tuaj me mijëra njerëz si nga ana materiale dhe nga ajo morale? Dëshironi të jetoni në mënyrë të shëndetshme? Dëshironi t'ua mësoni këtë edhe të tjerëve?

Ne prej 10 vitesh punojmë që edhe Ju ta gjeni kalimin e duhur të kohës, të keni një qëllim në jetë. T'i jepni familjes siguri materiale, t'i edukoni dhe shkolloni fëmijët në nivel evropian, dhe të krijoni në mjedisin tuaj kushte të tilla që me punën tuaj të ndihmoni edhe nevojtarët. Ne prej 10 vitesh ndërtojmë një shtet, me më shumë se 1 milion punonjës punojmë për Ju, që Ju nëse nuk mundeshit, të mësoni të buzëqeshni, t'u gëzoheni sukseseve tuaja, kjo kompani iu bën kranar sepse iu vlerëson rezultatet, dhe gëzojmë së bashku kur arrini qëllimet tuaja.

Koha është e pakët, Ju duhet ta vendosni që këtë kohë e kaloni me ne, e shfrytëzoni atë në mënyrën e duhur dhe bashkoheni me skuadrën Multi Level Marketing me zhvillimin më dinamik në Europë.

Të festojmë së bashku, të festojmë 10 vitet e kaluara bashkë. Takohemi më 26 maj në Ditën e Suksesit! Përpara FLP Hungari!



Dr. Sandor Milesz

DR. SANDOR MILESZ



Mundësitë e pa



FERENCNE TANACS
senior manager



FERENC TANACS
senior manager



Me drejtimin e programit në mënyrë tepër elegante nga senior managerët Ferenc Tanacs dhe Tanacs Ferencne dhe pjesëmarrjen e mijëra distributorëve nisi dita e suksesit të marsit të Shpk-s Forever Living Products Hungari në Arenën Sportive Laszlo Papp.

Ata thirrën në skenë, pra në bordin e anijes **Dr. Sandor Milesz**, i cili në përshëndetjen e tij bëri të njohur rezultatet e jashtëzakonshme të rajonit, falenderoi punën e madhe të palodhur mësimdhënëse të Sonya-s që bashkëpunonjësit tanë mund të marrin pjesë në një kurs përgatitor me nivel të lartë.

Pasoi shfaqja e tangos argjentinase e duetit kampion të Europës, **Johanna Kulik** dhe **Josip Bartulovic**, e cila u ndoq me vëmendje të madhe nga publiku i Arenës, i cili në fund të shfaqjes mahnitëse shpërtheu në duartrokitje të mëdha.

Profesori **Dr. Jozsef Pucsok** dhe djali i tij **Dr. Marton Jozsef Pucsok** me elegancën e profesionizmin e tyre të zakonshëm folën rreth rolit të plotësuesve ushqimor në mënyrën e shëndetshme të jetesës, rreth efekteve të tyre dhe përgjegjësisë së anëtarëve të Forever-it në këtë punë të bukur që përcjell njohuritë.

Përvojat me produkte u drejtuan në mënyrë tepër të këndshme nga bashkëpunonjësja jonë mjeke **Dr. Nikolett Dosa**, ndërkohë që në skenë thirri bashkëpunonjësit e saj të shëndetësisë të pranishëm të cilët ndanë me ne përvojat dhe mbresat e tyre më të rëndësishme në fushën e shëndetit.

Në skenë pasoi radha e gjatë e **supervisorëve dhe asistent managerëve** të cilët morrën për herë të parë emblemen e tyre të shqiponjës nga drejtori gjeneral. Ishte një ekperiencë e bukur të festoje së bashku me qindra njerëz në skenë.

Pas pushimit bashkëpunonjësi ynë manager **Zoltan Nagy** në leksionin e tij na tregoi tërësinë e sistemit marketing Forever Living, mundësitë e pashtershme dhe natyrisht edhe faktorët njerëzor që gjenden në të.

Cotton Club Singers i formuar përsëri e kënaqi publikun e Forever-it, i cili në fund

i falenderoi duke duartrokitur në këmbë këtë shfaqje të jashtëzakonshme.

Bashkëpunonjësi ynë senior manager **Robert Rudics** me njohuri të sigurt dhe të bazuara i udhëhoqi mijëra dëgjuesit në sekretet e ndërtimit të biznesit. Nëpërmjet shembullit të tij personal shpjegoi teknikat që ndihmojnë rritjen e vazhdueshme të një rrjeti stabil.

Në skenë pasoi kualifikimi i Klubit të Sundimtarëve të shkurtit, ku vendin e parë e arritën senior managerët **Janos Tamas** dhe **Tamas Janosne**.

Në skenë u ngjitën managerët tanë të rinj të cilëve iu dha mundësia të prezantohen dhe të falenderojnë sponsorët dhe linjat e tyre të sipërme të cilët i ndihmuuan ata në ndërtimin e rrjetit. Në fund erdhën të kualifikuarit e rinj të



ashtershme të FLP-s

Programit Motivues të Makinës të cilët u folën bashkëpunonjësve të tyre rreth pikësnyimeve dhe mundësive të reja.

Bashkëpunonjësja jonë soaring manager Terezia Herman në leksionin e saj foli rreth tipareve njerëzore, kërkesave dhe mundësive që karakterizojnë rrjetndërtuesin e mirë. E falenderojmë për leksionin e saj shumë të mirë.

Safir manageri **Istvan Halmi** me dinamizmin dhe vrellin e tij të zakonshëm iu drejtua anëtarëve të Forever-it duke i thirrur ata drejt një mundësie të madhe, sepse së bashku në një skuadër të madhe mund t'i vëmë vetes pikësnyime të mëdha. E falenderojmë për leksionin e tij të shkëlqyer.

Në Ditën e Suksesit pasoi kualifikimi i mijëra assistant supervisorëve të cilët si hap i parë në jetën e tyre morrën medaljen e tyre të parë të shqiponjës.

I mirëpresim të gjithë në Ditën e Suksesit të përvjetorit!











FLP gjithmonë



ZRINKA VRANEŠ
manager



VASILIJE NJEGOVANOVIĆ
manager



Aktivitetin tonë Success Day të marsit e organizuam në praninë e managerëve dhe distributorëve tanë të vullnetshëm në kinemanë e Qendrës UNITIC të Sarajevës. Drejtuesit e programit, managerët e suksesshëm Zrinka Vranes dhe Vasilije Njegovanovic e drejtuan me një lirshëmri të këndshme programin e Success Day.

Enra Hadzovic, drejtorja e zyrës së Sarajevës i përshëndeti të pranishmit dhe tregoi mundësitë e shumta të FLP-s të cilat u ofrojnë shpresa të mëdha atyre që dinë t'i shfrytëzojnë!

Ishte një kënaqësi e madhe për ne të përshëndesnim në radhët tona mysafirët nga Hungaria! Aktivitetin tonë e nderuan me praninë e tyre drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz** dhe manageri ynë drejtues **Jozsef Szabo**. I falenderojmë që bënë këtë rrugë të gjatë dhe na kushtuan kohën e tyre të lirë të pakët.

Dr. Slavko Paleksic, drejtori rajonal i Bosnia-Hercegovinës, në fjalën e tij përshëndetëse theksoi sukseset e arritura në vitet e kaluara nga FLP-ja, dhe iu lut të gjithëve që ta përcjellin dhe ta ndihmojnë mëtej mentalitetin e komunitetit tonë.

Pas kësaj në skenë u ngjiti **Dr. Sandor Milesz**. Fjalimi i tij i thënë në gjuhën boshnjake i preku thellë të gjithë! E falenderuam për ndihmën e madhe dhe miqësinë e tij me të cilën ka ndihmuar punën tonë të përbashkët gjatë viteve të kaluara.

Grupi kërcimtar **“Face to Face”** me shfaqjen e tij të shkëlqyer e ngriti edhe më lart gjendjen e mirë shpirtërore të pjesëmarrësve të aktivitetit tonë.

Këshilltarja jonë mjeke **Dr. Esma Nisic** me një profesionizëm me nivel të lartë dhe dëshmitë e saj të shumta shpjegoi se përse FLP-ja është e mirë gjithmonë dhe kudo. Në leksionin e saj foli rreth efektit të dëmshëm të disa produkteve artificiale në krahasim me ato natyrore. Faleminderit Esma!

Pjesa e programit të aktivitetit Success Day që bën fjalë rreth përvojave



dhe kudo



me produkte të konsumatorëve dhe mjekëve shkakton gjithmonë një interesim të madh në radhët e publikut. Me drejtimin e bashkëpunonjësit tonë manager **Safet Mustafic** fituam një pamje të gjerë rreth efektit të mirë të produkteve FLP.

Kualifikimi i **supervisorëve** të rinj dhe shpallja e **Top 10** të Bosnia-Hercegovinës shkaktoi një entuziazëm të madh. Të kualifikuarve tanë u uruam suksese në punë dhe shumë fat! Kështu mëtej!

Bashkëpunonjësja jonë manager **Meliha Dragic** i dha leksionit të saj të shkëlqyer titullin “Përgjigjuni preteksteve të bashkëpunonjësve tuaj”. Foli me përkushtim të madh rreth mundësisë që ofron FLP-ja dhe na tregoi gabimet e mundshme që bëjmë gjatë bisedave me bashkëpunonjësit tanë të rinj. Meliha, faleminderit për këshillat e dobishme!

Pas kësaj në skenë bashkëpunonjësi ynë manager **Zlejko Glavinka** prezantoi produktet e reja të FLP-s. Zlejko me profesionizmin e tij të zakonshëm na i pasuroi njohuritë pa asnjë fjalë të tepërt. Të lumtë Zlejko!

Pasoi një moment i shkurtër shplothje gjatë të cilit **Lemana Ena Saracevic**

na ngrohu zemrat me “Sretni ljudi” (Njerëz të lumtur), këngën më të bukur të fëmijëve të 2006-ës.

Pas kësaj salla e Qendrës UNITIC pothuajse “shpërtheu” nga shfaqja e managerit më të suksesshëm të Hungarisë. Janë pak ata që dinë të mbajnë një leksion kaq mësimdhënës, plot me emocione dhe forca pozitive si **Jozsef Szabo!** Në leksionin e tij foli rreth hapave të para në karrierën e tij të FLP-s dhe i qetësoi të gjithë që asnjëri s’e ka të lehtë të fillojë një diçka krejt të re, sido që ta bëjë. Me shembullin e vet tregoi se çfarë suksesesh mund të arrihen nëse nuk lëkundemi nga vështirësitë e fillimit! E falenderojmë të gjithë që nderoi aktivitetin tonë me praninë dhe leksionin e tij, dhe shpresojmë të na vijë shpeshherë si mysafir!

Të gjithë e dimë që hapat e para janë më të vështirat për t’u hedhur, prandaj u bashkuam që **assistant supervisorët** tanë t’i hedhim më lehtë ato. I pritëm me kënaqësi ata në skenë ku u dhamë medaljet e merituar dhe urimet tona për suksese të mëtejshme në punën e tyre.

ERNA HADZOVIC
Drejtorja e zyrës së FLP Sarajevës



Të ndihmojmë deri në sukses



**IVANKA
VIDIČEK**
manager



Managerja nga Zagrebi, Ivanka Vidicek, është shumë e njohur në radhët e bashkëpunonjësve të saj. Me thjeshtësinë, çiltërsinë dhe dashamirësinë e saj i bëntë gjithë për vete. E ndoqëm me kënaqësi kursin përgatitor. Ivanka përshëndeti anëtarët e rinj, punonjësit e ardhur nga rajone të ndryshme kroate, dhe natyrisht edhe mysafirët e ardhur nga vendet fqinje.



Programin e filluam me një film pesëmbëdhjetë minutash me titull “Të ndihmojmë deri në sukses”. Filmi bënte fjalë rreth mënyrës si të arrijmë qëllimet tona, si të realizojmë shpresat dhe ëndrrat tona. Siç e pamë shumë njerëz patën sukses dhe treguan se realizimi i ëndrrave është shumëherë më i thjeshtë nga ç’e mendojmë.

Personazhi i përhershëm i ditëve të suksesit është **Dr. Laszlo Molnar** i cili tregoi të rejat e zyrës. Me këtë rast ai

foli rreth filmit të parë së bashku. Thase i njez gjithë personazhet e filmit dhe që gjatë gjashtë viteve të kaluara ka udhëtuar në shumë vende të botës. Kjo mundësi është e hapur edhe për të tjerët. Të gjithë mund të udhëtojnë. Dhe jo vetëm mund të udhëtojmë. FLP-ja mund të na ndryshoj jetën. Ashtu siç ia ndryshoi edhe atij. Me kalimin e dy viteve bleu apartament, në oborr qëndrojnë dy makina të reja dhe paguan edhe shkollën e vajzave. Është një ndjenjë e mrekullueshme kur njeriu mund të jetojë me punën e tij.



FOTOGRAFOI: DARKO BARANASIC



Punën tonë e ndihmojnë CD-t dhe DVD-t tekstin e të cilave e përkthejmë me ndihmën e punonjësve të zyrës së Beogradit dhe së shpejti mund të sigurohen nga të gjithë.

Në vazhdim u dëgjuan këngë që na prekën me flladin e të kaluarës. Këngëtarja e re dhe mësuesja e gjuhës kroate-anglisht, **Iva Jelic**, këndon në dy teatre. Sfondin muzikor e dha **Ivan Barisic**, dhe ndërkohë u dëgjuan meloditë e njohura: “E di që të dua...”, “Buzëqeshje...”.

Nga leksionet e **Dr. Branka Molnar-Stantic** mësojmë gjithmonë shumë. Mjekja specialiste citologe është personi i duhur që mund të flas rreth rolit të produkteve FLP. Leksionin e përgatiti së bashku me **Dr. Snjezana Tomanovic**, e cila i bëri të njohur informacionet e rëndësishme në Ditën e Suksesit të Beogradit. Dr. Molnar e ndryshoi

materialin vetëm duke marrë parasysh të dhënat statistikore të Kroacisë. Përveç shifrave të ndryshme dëgjua edhe që në rajonin kroat takohen gjithmonë e më shpesh me probleme të shterpërisë, u njohëm me organet riprodhuese të femrës dhe mashkullit, faktorët që shkaktojnë shterpëri, diagnostizimin e shterpërisë dhe si përfundim dëgjua që me mënjanimin e alkolit, duhanit, si dhe disa ilaçeve këto probleme mund të zbuten, dhe natyrisht është i rëndësishëm edhe roli i produkteve FLP. Ishte një leksion tepër me vlerë dhe mësimdhënëse.

Pas një mungese të shkurtër përshëndetëm përsëri në radhët tona **Dr. Albert Keresztenyi**-n, managerin dhe stomatologun nga Rijeka, një nga rrjetndërtuesit më të mëdhenj kroat, drejtuesin e njohur të përvajave me produkte. Albert-i i njeh shumë mirë produktet FLP dhe efektet e tyre mbi organizmin e

njeriut. Me këshillat e tij të mençura dhe me vlerë i zgjeron njohuritë tona në lidhje me efektin e mirë të produkteve dhe na nxit t’i kushtojmë rëndësi parandalimit.

Pas përvajave me produkte u shplohëm përsëri me këngët e Iva-s dhe Ivan-it, të cilët na argëtuan me këngët e **Dimi Stantic-it dhe Tedi Spalato-s**.

Drejtori Dr. Laszlo Molnar në Ditën e Suksesit na tregoi rregullisht të rejtat e zyrës. Ndërkohë Dr. Molnar është një nga rrjetndërtuesit më të suksesshëm të Kroacisë dhe zotëron një nga strukturat më të fuqishme në Slloveni. Në leksionin e tij foli rreth mënyrës se si mund të marim përgjigje pozitive nga bashkëpunonjësit tanë potencial dhe si të dallojmë prioritetet. Çfarë është suksesi dhe si mund ta prezantojmë këtë brenda kuadrit të biznesit MLM. Tha se është e rëndësishme të flasim





sa më shumë në mënyrë që të shtohen sa më shumë anëtarët e skuadrës sonë. Në biznesin MLM ekzistojnë rregulla bazë dhe ligje matematikore. U njohëm me teknikën me katër kyçe, përdorimin e kësaj në praktikë, si dhe me pyetjet që i nxisin bashkëpunonjësit tanë të ardhshëm të mendojnë dhe nëpërmjet të cilave e kanë më të lehtë të vendosin marrjen përsipër të mundësisë së biznesit.

Në skenë përshëndetëm bashkëpunonjësit tanë më të suksesshëm, ata që arritën një shkallë të re. Me këtë rast ishin të parët që morrën shqiponjën, simbolin e ri të kompanisë sonë.

Kurrë mos thuaj kurrë – ishte mesazhi i supervisorës nga Zagrebi, **Snjezana Fadljevic**, në leksionin e saj. Snjezana ka bërë edhe më parë disa prova në lidhje me biznese



MLM, por tek asnjëri nuk e gjeti vetveten. Problemi ishte ose me produktet, ose me njerëzit, pastaj “me produkte jashtëzakonisht të mira” u shfaq sponsori i tanishëm, **Momo Zutinic**, entuziazmi i të cilit iu ngjiti edhe Snjezana-s. Dhe megjithëse kishte menduar që kurrë nuk i afrohet më asnjëlloj biznesi MLM, tani e mendon ndryshe dhe bën

gjithçka që me ndihmën e produkteve të shkëlqyera dhe njerëzve të mirë të bëhet e suksesshme.

Senior manageri nga Hungaria, **Tamas Biro**, na ka vizituar shpeshherë, dhe në çdo rast ua përcjell me çiltërsi njohuritë e tij kolegëve kroat. Në këtë rast foli rreth thellimit dhe zgjerimit. Por zhvillimi i biznesit nuk varet nga kjo. Zhvillimi i biznesit varet nga qëndrimi dhe vullneti ynë. Është e rëndësishme që të punojmë në qytetin tonë, por njëkohësisht duhet t'i kapërcejmë kufijtë e tij. FLP-ja është një mënyrë jetese, dhe nuk duhet të lemë asnjë rast pa shfrytëzuar, madje duhet t'ua ofrojmë edhe të tjerëve produktet dhe mundësinë e biznesit.

Në fund të Ditës së Suksesit u dhamë shqiponjat **assistant supervisorëve** të rinj. Ata tani hapën krahët e tyre dhe fluturojnë gjithmonë e më lart.

DR. LASZLO MOLNAR
Drejtori rajonal i FLP Kroacisë





JOŽICA ZORE

managere
anëtare e President's Club

Të gjithë kanë shanse të njëjta për sukses

Aktivitetin e hapën me elegancë dhe me valsin e Vjenës kërcimtarët tanë, **Valerija dhe Aljaz**, sollën mes nesh pranverën dhe ndjenjat fluturuan larg. Pastaj u përgatitëm për punën serioze.

Në sallë përshëndeti një zë i panjohur, i cili pastaj thirri në skenë nismëtarën dhe gruan e parë të Forever-it të Sllovenisë, manageren **Jozica Zore**, e cila ishte edhe drejtuesja e programit.

Ajo përshëndeti në mënyrë të veçantë mysafirët e ardhur nga zyra krates, **Branka Daja**-n dhe burrin e saj, drejtuesen e sallonit të kozmetikës Sony të Zagrebit dhe punonjësen e re të zyrës së Zagrebit, **Gordana Geric**, si dhe dy managerët të suksesshëm: **Jadranka Kraljic Pavletic dhe burrin e saj Nenad**.

Me përshëndetjen e saj të ngrohtë Jozica ma përforcoi bindjen që jemi të pandalueshëm, të cilën e vërtetova edhe vetë me prezantimin e anëtarëve slloven të **President's Club**.

U thashë distributorëve tanë që kemi në plan shpërnguljen në një vend të ri, hapjen e sallonit tonë kozmetik Sonya dhe që planifikojmë një të ardhme edhe më të bukur për të gjithë.


Rreth realizimit të planeve foli drejtuesja e programit, managerja Jozica Zore. Pastaj pasoi leksioni me titull „O, Forever...”. Historia e Forever-it, literaturë, plan marketing, si të bëhemi të suksesshëm... E thjeshtë! Shikoj

fytyrat e reja në sallë nga të cilat rrezaton entuziazmi. Jozica tregoi në mënyrë të shkëlqyer se çfarë jete siguron Forever. Natyrisht nuk është puna gjithçka. Me siguri e keni dëgjuar shpeshherë fjalinë: „Unë nuk jam i aftë për këtë, unë jam ndryshe, ai është më i mirë, ai e ka më të lehtë...” E njohur, apo jo? Natyrisht, edhe ky qëndrim është pa bazë. Këtë vërtetoi me ndihmën e drejtueses së programit **Jozica Arbeiter**.

Na thirrën në skenë ku na grupuan sipas moshës, rajonit, numrit të këmbës... Çfarë bëhet këtu? Pastaj u bë e qartë se çfarë donin të tregonin. Pasi krijuan grupet e ndryshme, morrëm dorën e njëri-tjetrit dhe krijuam një rreth. E shikoni, jemi të ndryshëm, por prapë të njëjtë, të gjithë kanë shanse të njëjta për sukses, jemi së bashku! Jemi një familje! Dhe çfarë tjetër e përfaqëson më mirë forcën se sa familja!

Natyrisht, për suksesin duhet edhe të veprojmë. Hapi i parë është trajtimi i trupit tonë. Si ta mbajmë, si ta krijojmë bukurinë tonë me ndihmën e produkteve FLP, rreth kësaj foli punonjësjë e sallonit të kozmetikës Sonya të Zagrebit, **Gordana Geric**. Pavarësisht se masazhi dhe trajtimi i fytyrës i përket fushës së interesit të gjinisë më të bukur, duhet ta pranoj se edhe unë vetë e dëgjova me vëmendje leksionin, pasi s'e kisha idenë se sa produkte kozmetike të shkëlqyera kemi. Faleminderit Gordana për leksionin motivues dhe të urojmë suksese të mëtejshme.

E shtunë pranverore me diell dhe Success Day në hotelin Slon të Lubjanës. Ishte një ndjenjë e mrekullueshme të shikoje fytyrat e reja që prisnin dhe që ishin plot me dëshirë për njohuri dhe sukses. Ndodhen në vendin e duhur.





U entuziazmuam në mënyrën e duhur për të shijuar shfaqjen e mëpasshme. **Valerija dhe Aljaz.** Tango, salsa dhe kërcimet e tjera mahnitëse na bënë për vete. Faleminderit për shfaqjen, jam i bindur se së shpejti do t'i përshëndesim ata në parinë e botës kërcimtare sllovene.

Pasoi momenti më i bukur i Success Day. Natyrisht për ata që ishin të vullnetshëm dhe patën besim tek forca e Forever-it. Kualifikimet! Në skenë ndoqën njëri-tjetrin **supervisorët, assistant managerët dhe managerët** e rinj. Buzëqeshje, krenari dhe vlerësim. Treguan se si e arritën suksesin, të gjithë pa përjashtim thanë se besuan në këtë çështje. Kështu është, duhet të besojmë! U uroj të gjithëve suksese të shumta në rrugën e Forever-it!

Ngjituni akoma më lart! Në lartësitë ku fluturojnë anëtarët e **Conquistador Club**. I përgëzojmë edhe ata dhe u urojmë që të fluturojnë akoma.

Pas vlerësimeve na ra mirë një pushim i shkurtër, pas të cilit **Marjan Smode**, këngëitari i njohur slloven u kujdes



për atmosferën e mirë. I dëgjuam me kënaqësi këngët e njohura, pasi Marjan-i ndodhet prej vitesh të tëra në botën e muzikës, këngët e tij njihen mirë si nga të rinjtë, edhe nga të moshuarit.

Çfarë rastësie që drejtuesja e programit të Success Day ishte pikërisht Jozica. Dhe Marjan-i natyrisht nuk i mbeti borxhli, pasi u dëgjua menjëherë kënga: „Jozica, ku ishe kur të kërkova...” Në sallë natyrisht buzëqeshën të gjithë.

Përvoja, përvoja. Çfarë do të bënim pa to. Në këtë rast prezantimi i përvojave të konsumatorëve ishte i jashtëzakonshëm. Kjo pjesë e programit u drejtua nga **Dr. Igor Praprotnik**. Thirri në skenë **managerët** e rinj dhe për mua deri më sot është e fshehtë se përse u interesua aq shumë pas Multi Maca-

s. Vajzat e lavdëruan shumë produktin, me siguri e dinte se çfarë duhet të pyeste nga ato. Falenderojmë Igor-in për prezantimin e shkëlqyer të përvojave të konsumatorëve, besoj se e gjeta drejtuesin e kësaj pjese të programit të cilit ia jap me dëshirë këtë detyrë edhe në të ardhmen.

Përse mendoni kur them: bombë energjie? Përgjigja e parë është natyrisht Pomesteen Power, kurse tjetra **Jadranka Kraljic Paveltic**. „Shfrytëzoje ose lëre” – ky ishte titulli i leksionit të saj. Na tregoi qartë se si mund të bëhemi të suksesshëm, si mund ta ruajmë besimin në vetvete. Jam i bindur se nga leksionet e sotme mësuam gjithçka që na nevojitet. Jadranka na thotë të nisemi, të fillojmë të jetojmë! E falenderojmë Jadranka-n për leksionin e ri të shkëlqyer!

Të mbushur me energjitë e saj të jetës dëgjuam përsëri këngët e **Marjan Smode-s**, dhe shumë prej nesh u ngritën në kërcim. Kërçem deri në pikën kulminante të aktivitetit. I pari ishte **Dr. Miran Arbeiter** i



cili foli rreth rolit të antioksidantëve. Leksionet e tij janë gjithmonë interesante, edhe ky i sotmi ishte tepër mësimdhënës dhe interesant. E dinjt se sa produkte përmbajnë antioksidant? S'ka gjë, tani e dini, dhe s'keni asnjë shkak për ta ndërjër keq veten. Faleminderit Miran për energjitë e shumta që shpenzon për zgjerimin e njohurive tona!

Dalëngadalë Success Day po i afrohej fundit, por në ditën e sotme premtova edhe një pikë tjetër kulminante. "Rreth pijeve". Soaring manageri **Tomo Brumec** prezantoi paletën e pijeve FLP. Gjithmonë kur

mendoj se s'mund të më thonë më asgjë të re, Tomo më tregon se kam akoma çfarë të mësoj. Tregoi me hollësi përbërësit dhe efektet e pijeve të ndryshme, pastaj premtoi që do ta vazhdoj prezantimin në të ardhmen. Tomo, do ta përmendim premtimin e dhënë, dhe të falenderojmë për leksionin. Sot arritëm pothuajse gjithçka. Por s'ka ardhur akoma fundi. Pasuan zogjtë shqiponjë të cilët rriten dhe mësojnë të tjerët të fluturojnë. Mbushem gjithmonë me kënaqësi kur shikoj në skenë të rinj që marrin vlerësimin e parë për përpjekjet e tyre. Kam besim tek ju dhe e di që do të fluturoni

gjithmonë e më lart. Me këtë përfundoi Success Day.

Si përfundim dëshiroj t'iu bëj të njohur mendimin që më ndoqi sot gjithë ditën: "Fitimtarët janë ata që në mëngjes shohin rrotull dhe gjejnë rrethanat e përshtatshme për ta. Nëse nuk i gjejnë, atëherë i krijojnë ato." (George Bernard Shaw)

Krijoni të ardhmen tuaj me ndihmën e Forever-it.

ANDREJ KEPE
Drejtori rajonal i FLP Sllovenisë

Na presin mund



**DANIJELA
BARNAK**
senior manager

Të pranishmit u përshëndetën edhe nga drejtori rajonal i FLP Serbisë **Branislav Rajic**. Në fjalën e tij përshëndetëse ai tregoi të rejtat e kompanisë sonë dhe ngjarjet që ndodhen përpara nesh, në të cilat e përfaqësojmë me dinjitet vendin tonë në radhët e Forever-it. Na presin mundësi të mrekullueshme, vetëm t'i dallojmë ato dhe t'i ndajmë me çiltërsi me bashkëpunonjësit tanë më të mirë.

U krijua një atmosferë e shkëlqyer nga mysafirët e ardhur nga Smederevo, grupi i muzikës popullore "**Zabranjeno voće**", të cilët me një shfaqje të përkryer prezatuan muzikën popullore origjinale qindra vjeçare. Jemi të sigurt që anëtarët e grupit do ta gjejnë vetveten në punën e FLP-s, kurse ne u urojmë suksese të shumta në karrierën e tyre muzikore.

Wellness do të bëhet një faktor vendimtar në vitet e ardhshme, sepse edhe në ditët e sotme përbën një pjesë të domosdoshme për njerëzit që ushtrojnë një mënyrë jetese të shëndetshme.

Sporti dhe argëtimi lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me produktet e mrekullueshme të FLP-s. Bashkëpunonjësi ynë manager **Dr. Stevan Vuksa** tregoi efektet e tyre të mira në parandalim, si dhe na dha udhëzime të hollësishme se si t'i përdorim ato gjatë wellness-it.

Pjesën më të rëndësishme të çdo aktiviteti Success Day e përbëjnë përvojat me produkte të konsumatorëve dhe mjekëve që i përdorin ato gjatë praktikës së tyre. Këto përvoja tregojnë efektin e produkteve me cilësi të shkëlqyer gjatë shfaqjes së problemeve të ndryshme shëndetësore. Falenderojmë **Dr. Miro Simic** për drejtimin me shumë profesionizëm të kësaj pjese të programit.



Kualifikimet përbëjnë fytin e punës së madhe të bërë në marketingun Forever. Mbushemi gjithmonë me kënaqësi kur në skenën e Success Day-t përshëndesim **supervisorët, assistant managerët dhe**

Në aktivitetin tonë të parë të pranverës në Beograd erdhën shumë punonjës të Forever-it nga gjithë rajoni Sllavojugor. Drejtuesit e programit ishin bashkëpunonjësit tanë senior manager Danijela dhe Vladimir Barnak. I falenderojmë për drejtimin mjeshtëror të programit me të cilin e bënë edhe më solemn aktivitetin tonë.

FOTOGRAFOI: DIMITRIJE OSTOJIC

dësi të mrekullueshme



managerët e rinj. U urojmë suksese në punë, sepse jemi të sigurt se nuk do të qëndrojnë në nivelin e arritur dhe do të arrijnë nivele edhe më të larta në shkallët e Planit Marketing.

Bashkëpunojësja jonë soaring manager **Dragana Janovic** në leksionin e saj me titull **“Përse, si dhe çfarë duhet të punojmë?”** – me ndihmën e njohurive të saj të shkëlqyera rreth rrjetit marketing – u dha përgjigjet e duhura pyetjeve të të pranishmëve. Marrdhëniet tona njerëzore janë investim për të ardhmen, kurse FLP-ja është mjeti me të cilin mund t’i realizojmë ato. Këshilla e Dragana-s mund të jetë vendimtare për ne: të ecim drejt qëllimeve tona vetëm me ata të cilët ashtu si ne kanë pikësynim një pamje më bukur të ardhmeje. Pyetjes që kush duhet ta bëjë, përgjigja e saj ishte: TI, TANI MENJËHERË!

Përvojat personale të siguruar gjatë konsumimit të produkteve tona përbëjnë bazën e një procesi të mrekullueshëm, në të cilin ushtrojmë

një mënyrë jetese të shëndetshme, ua këshillojmë atë edhe të tjerëve dhe kujdesemi për konsumatorët tanë. FLP-ja ofron një shëndet, bukuri dhe pavarësi materiale, me të cilat çdo njeri mund të plotësojë nevojat e tij. Sekretin e suksesit të arritur në radhët e kompanisë FLP na i tregoi mysafirja jonë nga Hungaria, soaring managerja **Dr. Terezia Samu**. Doktoresha Samu ishte një nga mjeket e para të rajonit Sllavo-jugor që e pranoi mentalitetin e Forever-it. Puna e saj e madhe shumëvjeçare u kurorëzua nga një karrierë e mrekullueshme distributori në FLP, dhe leksioni i saj me titull **“Si të kujdesemi për konsumatorët?”** u ofroi të gjithëve një rrugëzgjdhje të përsosur për fillimin e një karriere të shkëlqyer në FLP. Nëse i pranojmë këshillat e saj, atëherë na pret vetëm puna e vullnetshme, dhe me siguri do t’i arrijmë qëllimet tona.



Kompania FLP me realizimin e programit motivues “Programi i Makinës” na siguron mundësinë e blerjes së makinës. Me mbylljen e programit të vjetër **Mirjana Micic** dhe **Vilmos Harmos** hynë menjëherë me sukses në programin e mëpasshëm. I

përgëzojmë nga zemra dhe u urojmë rrugë të mbarë në makinën e tyre të re.

Rrezatimi i ngrohtë i zemrës së tyre të madhe i nxit të gjithë në mjedisin rrethues të ndjekin hapat tyre dhe të arrijnë suksese të ngjashme me ta.

As ritmi i përshpejtuar i ditëve dhe as detyrimet e shumta nuk e çënuan mirëkuptimin në familje, sepse për ta ajo qëndron gjithmonë në vend të parë. **Zoran Oכולjic** arriti sukses të madh në radhët e FLP Serbisë sepse arriti nivelin e **soaring managerit**.



Ocokoljic! Dy kualifikime, dy skuadra, një familje e cila funksionon në mënyrë të përkryer dhe kudo që shfaqet rrezaton energji pozitive. Nuk gjejmë dot fjalët e duhura me të cilat mund t'i shprehim falenderimet tona këtij çifti të ri që janë pjesë e FLP-s. U urojmë suksese të shumta në jetën dhe punën e tyre të përditshme.

Falenderimet tona i shprehëm me shfaqjen e korit të fëmijëve të njohur të TV Beogradit **Neverne bebe**.

Është një ndjenjë e mrekullueshme kur shohim punonjës dhe karriera të reja në radhët e FLP-s. Në radhët e Klubit të Sundimtarëve marrin pjesë punonjësit që e rrisin shumë qarkullimin e tyre në krahasim me periudhën e kaluar. Urime për anëtarët e Klubit të Sundimtarëve!

Njoftuam se aktivitetin tonë të ardhshëm do ta mbajmë më 19 maj në Pallatin e Sindikatave, dhe pas kësaj u uruam suksese të shumta assistant supervisorëve të rinj dhe u dhamë medaljet e shqiptonjës që simbolizon FLP-n.



Çfarë e vërteton më mirë shprehjen, që pas një burri të suksesshëm qëndrën gjithmonë një grua e suksesshme, se sa bashkëshortja e tij, **safir managerja** e re, **Danijela**

BRANISLAV RAJIC
Drejtori rajonal i FLP Serbisë

Dita e Kozmeti



KATA UNGAR
managere



Më 22 mars mysafirët, lektorët dhe organizuesit gjithashtu e prisnin me emocion fillimin e programit. Skena që dukej si sallon bukurie ishte plot me buqeta të bukura lulesh dhe produkte të vendosura me rregull. U ndez muzika dhe filloi dita e shumëpritur e kozmetikës.



FOTOGRAFOI: BELA KANYO

(Vazhdim nga numri i mëparshëm)

Ishte një gëzim i madh për mua leksioni i mëpasshëm i cili kishte titullin "Magji me ngjyrat". U kënaqa mëtej me bukuritë e gjuhës sonë, pasi pasoi aktorja e njohur **Enikó Detar**. E pabesueshme që kur gjeti kohë mes shumë punëve që ka për të përgatitur një leksion të tillë të shkëlqyer! Mendimet e saj mahnitëse mbështeteshin në vlera të vërteta



Falë efektit të tyre të favorshëm mbi lëkurën luajnë rol të rëndësishëm edhe në kozmetikë. Skuqësi i fytyrës, ngjyrat e syve dhe buzëkuqi përmbajnë aloe vera, efektet e mira të të cilës mund t'i provojmë gjatë përdorimit të tyre. Bozso na tregoi edhe në praktikë se si di të sillet me këto lëndë kozmetike. Me botën e ngjyrave të makijazhit të përgatitur shkëlqeu kreativiteti i tij. Tek ai ekziston edhe vullneti, edhe përlujta gjithashtu.



arti. Njerëzit e adhuronin! Duke e pasuruar me përvojat e saj personale, foli rreth përdorimit të pudrës dhe korrektorit. Na tregoi se përpara njerëzve duhet të dalim vetëm të përgatitur mirë, dhe Ajo duke e marrë përsipër këtë përgjegjësi erdhi këtu mes nesh.

Pas njerëzve të artit vazhdoi specialisti i skuqjes së fytyrës, ngjyrosjes së syve dhe të buzëve, **Laszlo Borsanyi**. Tek ai njohëm një mashkull të shumëanshëm, i cili e ndjen veten si në shtëpinë e tij në skenë, në kërcim dhe jashtë skene gjithashtu. Produktet e FLP-s kanë efekt të madh në funksionin e organizmit tonë.



ikës Sonya

Melinda Gulyas mbajti leksion rreth paletës Sonya duke përdorur shami me ngjyra. Ecëm nga hapi në hap në botën e ngjyrave. Shumë përvoja tregojnë se produktet dhe lëndët kozmetike me përmbajtje aloe vera kanë efekt të favorshëm kundër simptomave tipike të plakjes së lëkurës, si humbja e tonit, tendosjes, hollimi i lëkurës dhe tharja e saj. Përmbajtja e aloe vera-s e lëndëve tona kozmetike siguron trajtimin e lëkurës suaj gjatë makijazhit.

Berberja **Agota Trokodi** vetëm me përdorimin e Pro set-it për një moment krijoi përpara syve të shikuesve një gërshet të veçantë nga flokët e një modeleje, pastaj spacialistja kozmetike **Agi Horacsek** përgatiti një makijazh të vërtetë FLP-je të frymëzuar nga aloe vera.

-Përse kulla Sonya? pyeti **Tünde Hajcsik**, pastaj dha edhe përgjigjen e duhur. Suksesit fshihet në detaje. Morrëm përgjigje për mënyrën se si mund ta bëjmë më rezultativ biznesin tonë, nëse tregojmë me shifra se çfarë fitojmë me blerjen e kullës Sonya. Natyrisht duke theksuar efektin dhe vlerën e produkteve që ndodhen brenda saj.



Me personalitetin e saj feminor dhe harmonik, me përgatitjen dhe leksionin e saj të shkëlqyer i bëri të gjithë për vete.

U shfaq shoqja ime, femra e suksesshme dhe e bukur, **Mariann Szeker**. Tek ajo dukej qartë që i përdorte produktet. Me ardhjen e kohës së mirë kemi gjithmonë e më shumë shtytje që ta sjellim veten në formë. Këtë shërben përdorimi i Body toning kit. Fjalët e saj i zbuluroi me mbresat e saj të këndshme. Gjatë jetës sonë duhet të përballohem me faktin që cilësia e lëkurës ndryshon në gjithë sipërfaqen e trupit tonë. Problemet e celulitit dhe linjave të trupit përbëjnë origjinën e trajtimit kozmetik të tij. Përdorimi i rregullt i Body toning kit është një fillim i shkëlqyer, i cili rekomandohet të kombinohet me një masazh në Sallonin e Shërbimit Sonya, si rezultat i të cilit rritja e qarkullimit të limfës sjell përthithjen më të shpejtë të lëndëve vepruese.

Ndërkohë **Csilla Fülöp**, një nga masazhoretet e qendrës Sonya, tregoi në praktikë tek shoqja ime **Csilla**

Szekely se si duhet bërë mbështjellja e trupit. Modelja qëndronte përpara nesh me rroba banje, pastaj mbërriti në skenë e mbuluar me një mantel të bardhë, dhe shikonte rrotull me stilin e saj të zakonshëm flegmatik dhe të qetë. I mungonte vetëm pulti i televizorit në dorë, aq familjare ishte pamja. Rezultati i matjes ishte shokues për njerëzit, pasi me kalimin e një ore perimetri i trupit iu zvogëluar me një përmasë robe! Dhe për ruajtjen e rezultatit rekomandohet gjimnastika.



Dr. Edit Revesz Siklosne u shfaq në dërrasat që përbënin botën. E adhuroj atë që bën ajo. Foli rreth programit tonë Clean and Lean. Po, ky leksion është për të, pasi ata që e njohin prej kohësh e dinë që Edit e ka bërë atë për të cilën flet. Doli përpara distributorëve me një trup të formuar dhe të bazuar në studime, por prapë në mënyrë argëtuese, bëri të njohur programin, rezultatin përfundimtar të të cilit mund edhe të na i tregonte. Pasi kishte rënë nga pesha. Sa bindëse është kur dikush e bën, dhe jo vetëm flet rreth saj – thashë me

vete. E vendosa, do të bie nga pesha. Këshillat e dokoreshës Revesz mund të përdoren edhe në praktikë. Kush po vjen me mua?



Bukuria dhe shëndeti janë koncepte të lidhura me njëri-tjetrin. Ushqimi i një pjese të mirë të popullsisë karakterizohet nga pamjaftueshmëria e vitaminave dhe lëndëve minerale. Për këtë na foli **György Till**. Përvoja shumëvjeçare e siguruar në Qendrën e Shëndetit dhe Bukurisë që drejton së bashku me bashkëshorten e tij, **Margit Szep**, e bëri që për trajtimin e problemeve t'u rekomandoj atyre që i drejtohen rrugëzgjdhjet e ofruara nga natyra. Foli me një profesionizëm të madh rreth faktit që përveç zbukurimit të lëkurës është e rëndësishme të theksohet edhe niveli energjik dhe gjallëria e klientit, për të cilat aloe vera është plotësisht e përshtatshme.

Ndërkohë në sfond mund të ndiqnim në ekran masazh me katër duar. Edhe pamja e trajtimit kishte vlerën e një programi shplohës. Ne, femrave me çdo kusht, pasi modelja ishte ndërtuesi i suksesshëm i rrjetit, lojtari me trup fantastik i vaterpolit, **Andras Banhidi**, i cili u pasua nga bodybuilideri, **Janos Ignatko**. Pastaj në radhët e njerëzve buzëqeshje, pasi pyetjes që cili nga meshkujt dëshiron të provonte duart e masazhatoreve **Ildiko Hrnccsijar** dhe

Csilla Fülöp, një djal i ri u hodh me vrap, hoqi menjëherë pantallonat dhe u shtri në krevat. Nuk doli keq, dhe tregoi i kënaqur rreth eksperiencës.

Serinë e leksioneve të kësaj dite e mbylli **Dr. Terezia Samu**, e cila shpjegoi me hollësi se njeriu e periudhës së sotme e karakterizon gjithmonë e më shumë shëndeti i vetëdijshëm dhe e quan të rëndësishme ruajtjen e fuqive fizike



I lutemi Shpërndarësve tanë të nderuar, që në të ardhmen ti kushtojnë kujdes plotësimi të saktë të porosisive të produkteve dhe të formularëve të tjerë! Porositë e produkteve të korrigjuara (emri i porosisë) dhe të panëshkruara, me qëllimin për të shmangur gabimet, nuk mund ti pranojmë. Ju lutemi gjithashtu, të kujdeseni për plotësimin e saktë dhe të lexueshëm të formularëve të regjistrimit: me shkronja shtypi, me bojë të zezë ose blu. Në rastin e ndryshimit të adresës apo të emrit, ju lutemi të përdorni formularin e ndryshimit të të dhënave!

Në interes të sigurisë së çështjeve financiare ju lutemi, që në rastin e paraqitjes së bonuseve nëpërmjet të besuarit për këtë, ky person i besuar të sjell me vete edhe letërnjoftimin e tij! Sipas politikës ndërkombëtare të biznesit, çdo shpërndarës, që nënshkruan formularin e regjistrimit (kontratën), fiton të drejtën e blerjes së produkteve me çmim shumice, direkt nga zyrat. Gjithashtu, shpërndarës i regjistruar, ai bëhet vetëm gjatë blerjes së parë, duke paraqitur kopjen e dytë të formularit të regjistrimit së plotësuar më parë dhe dokumentin e porosisë së produktit të plotësuar.

E parregullt:

Asnjëherë mos blini ose shisni produkte në kanale të tjera elektronike apo njësi të shitjes me pakicë. Duke marrë parasysh mundësitë e ndryshme të shitjes nëpërmjet medias elektronike, sipas Forever Living Products: këto konsiderohen si njësi të shitjes me pakicë. Sipas politikës aktuale të biznesit qarkullimi i produkteve, ose publikimi i formularëve të FLP-s në njësitë e shitjes me pakicë është rreptësisht i ndaluar. Qarkullimi i produkteve me anë të medias elektronike mund të bëhet vetëm nëpërmjet faqes së internetit www.flpseeu.com. Iu njoftojmë që dorëzimi i kontratave pa autorizim është i parregullt, pranojmë vetëm kontratat me nënshkrim personal! Çdo nënshkrim tjetër konsiderohet si fallcifikim dokumentash!

Risponsorizim!

Dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen për rregullat e "risponsorizimit" të cilat gjenden në kapitullin e 12-të të Politikës së Biznesit. E rëndësishme është se risponsorizimi s'është proces automatik, por vjen në fuqi vetëm pas plotësimit të formularëve të përcaktuar (deklarata e risponsorizimit, fletë regjistrimi e re) dhe përgjigjes së kushteve. Në lidhje me rregullat e Politikës së Biznesit gabon ai që bashkëpunonjësit distributor të regjistruar njëherë i fut për herë të dytë pa plotësuar procesin e risponsorizimit.



NJOFTIMET E ZYRAVE TË HUNGARISË



- Zyra qendrore e Budapestit: 1067 Budapest, Szondi utca 34., tel: +36-1-269-5370.
Drejtori i marrëdhënjeve ndërkombëtare: Lenkey Péter.
- Magazina e Budapestit: 1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11., tel: +36-1-291-8995. Drejtori i rajonit: Lenkey Péter.
- Zyra e Debrecenit: 4024 Debrecen, Szent Anna u. 31., tel: +36-52-349-657. Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.
- Zyra e Szegedit: 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25., tel: +36-62-425-505. Drejtori i rajonit: Radóczki Tibor
- Zyra e Szekesfehervarit: 8000 Székesfehérvár, Sóstói út 3., tel: +36-22-333-167. Drejtori i rajonit: Földi Attila

Njoftojmë Shpërndarësit tanë të nderuar se vendi i organizimit të Success Day Forever të 26 majit 2007, që fillon në orën 10, është: Arena Sportive Papp Laszlo, 1143, Budapest, Stefánia út 2. I mirëpresim të gjithë! Dëshiroj t'u njoftoj edhe se në këtë ditë asnjë nga magazinat tona s'është hapur.

Produktet e Forever Living Products dalin në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Hungarisë. I lutemi Distributorëve të nderuar, që bashkë me formularin e tyre të regjistrimit të dorëzojnë edhe kopjen e lishencës së tyre, si dhe kopjen e dokumentit të paraqitjes së Zyrës së Taksave dhe Tatimeve të ndërmarrjeve. Ata partnerë të Hungarisë, të cilët për blerjet e bëra dëshirojnë të nxjerrin llogari në emrin e ndërmarrjes së tyre personale, mund ta bëjnë këtë vetëm në rast se dërgojnë dokumentet e duhura të plotësuar, dhe një kopje të dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i ndërmarrjes. Njoftimi, që ka të bëjë me këtë, është i nxjerrë në zyrat tona, por kolegët tanë mund t'ju njoftojnë edhe me fjalë në këtë aspekt. Numrat aktual dhe të mëparshëm të revistës mujore mund të lexohen në faqen tonë të internetit duke përdorur passwordin „forever”.

Njoftim rreth mundësisë së blerjes me ulje
Për të përdorur mundësinë e blerjes me ulje ju lutemi zbatoni rregullat e mëposhtme:

1. *Deklarata:* Ju lutemi që me vëmendje plotësoni saktësisht çdo pjesë të deklaratës. Nëse e dërgoni personalisht kolegët tanë i kontrollojnë të dhënat, por nëse e dërgoni me postë kjo gjë nuk është e mundur, prandaj ju lutemi që me një vëmendje të madhe kontrolloni të dhënat tuaja, sepse në rast gabimi sistemi i uljes së çmimeve nuk hyn në fuqi.

2. *Blerja:* Gjatë blerjes sistemi i ofron shumën maksimale të uljes atyre që e plotësuan deklaratën. Blerja do të thotë përdorimin e uljes së çmimeve ose pagesën e bonusave, kështu edhe blerja personale kërkon letërnjoftim me fotografi. Në rastin e blerjes si grup duhet të sillni autorizim të nënshkruar nga dy dëshmitarë të rregullt nga çdo person, për çdo porosi. Kolegët tanë i pranojnë porositë vetëm pasi i kanë kontrolluar këto gjëra. Në rastin e personave me deklaratë mungesa e letërnjoftimit apo e autorizimit sjell refuzimin e porosisë!

3. *Informimi:* Kolegët tanë nëpër magazina vetëm pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi dhe dorëzimit të autorizimeve japin informacione rreth shumës aktuale të uljes.

Bashkëpunonjësit me deklaratë dhe që i marrin bonusat e tyre në formë kuponash, mund të informohen rreth shumave të sakta në adresën Budapest, Szondi u. 34.

Dëshiroj t'u thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Distributort tanë të nderuar i marrin porositë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – me përputhje kohe – në çdo pikë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anullojmë dhe pikët i zbrisim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakojat merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania.

Porositë tuaja mund t'i bëni në mënyrën e mëposhtme:

- në telefon, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit. Numrat e telefonit: 061-297-5538, 061-297-5539, cel: 0620/456-8141, 0620/456-8149
- nëpërmjet internetit në adresën www.flpshop.hu,
- me sms në numrin e telefonit 0620-478-4732.

Çmimet e transportit:

Budapest	Provincë	
0-5 kg	640 Ft	1260 Ft
5-10 kg	1240 Ft	1720 Ft
10-30 kg	1520 Ft	1940 Ft
Mbi 30 kg	30 Ft/kg	30 Ft/kg



- Çmimet e mësipërme janë të vlefshme deri në 3 porosi/adresë, mbi 3 porosi llogarisim +200 Ft/porosi.
- Çmimi i postimit është 360 Ft/adresë.
- Siguracioni: deri në shumën 200 000 Ft e përmban çmimi i transportit, mbi këtë shumë për çdo 10 000 Ft është 50 Ft.
- Çmimet e mësipërme nuk përmbajnë TVSH-në prej 20%.
- Transportimi i porositve bëhet pas përputhjes paraprake në telefon. Shpenzimet e përputhjes në telefon përmbahen nga çmimet e mësipërme.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Hungarisë:

- Dr. Gabriella Kassai: +36-30-307-7426
- Dr. György Bakanek: +36-20-944-1442
- Dr. Laszlo Kerekes: +36-20-944-1442
- Dr. László Mezôsi, veteriner: +36-20-552-6792



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SERBISË

- Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381-11-3970-127.
- Zyra e Nisit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381-18-514-130, +381-18-514-131. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.
- Zyra e Horgosit: 24410 Horgoš, Rade Končara 80. tel.: +381-24-792-195. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.
- Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme: bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309-6382. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12:00-19.30, në ditët e tjera të punës 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.
- Shpenzimet e postës paguhen sipas kursit të PTT Serbisë të ditës

Të nderuar bashkëpunonjës!

U njoftojmë me kënaqësi se edhe sivjet shfaqim programin dobësues "Clean 9 dhe Lifestile 30". Gjatë periudhës së programit mund të paraqiteni dy herë në zyrat tonë për matjen e peshës, dhe në raport me uljen në përqindje të peshës dalin fituesit e çdo kategorie.

Programi "Clean 9 dhe Lifestile 30" zgjat nga 1 prilli deri më 30 qershor. Shkoni të mateni në zyrat tona. Të çlirohemi nga kilet e tepërta me paketën e produkteve Clean 9 dhe Lifestile 30! Qëllimi është peshë më e shëndetshme dhe shpërblimet me vlerë!

- që ndodh shërbimi, por FLP-ja e Beogradit i paguan vetëm nëse porosia e bërë në një numër kodi e kalon 1 pikë krediti.
- Nuk mund të bëhet hyrje nëpërmjet telefonit.
- Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosisni vetëm personalisht në zyrën tonë.
- Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash dhe gjithë llojet e formularëve. Distributorët tanë mund të blejnë edhe fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Serbisë:

- Dr. Biserka Lazarević dhe Dr. Predrag Lazarević: +381-23-543-318



NJOFTIMET E ZYRËS SË MALIT TË ZI

- 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića br: 20. tel: +381-081-245-402, tel/fax: +381-081-245-412. Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakic

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Malit të Zi:

- Dr. Laban Nevenka: +381-69-327-127



NJOFTIMET E ZYRAVE TË BOSNIA-HERCEGOVINËS



Zyra e Bijelinës

- Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg Đenerala Draže Mihajlovića br. 3., tel: +387-55-211-784, +387-55-212-605, fax: +387-55-221-780. Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.
- Zyra e Banja Lukas: 78 000 Banja Luka, Duško Koščica u. 22., tel.: +387-51-228-280, fax: +387-51-228-288. Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Paleksic. Orari i hapjes: në ditët e punës 9.00-16.30
- Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akifa Seremeta do. 10., tel.: +387-33-760-650, +387-33-470-682, fax: +387-33-760-651.. Orari i hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00-16.30, të martën, të mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit organizojmë një Ditë Suksesi Mini në zyrën e FLP-s. Drejtori i rajonit: Enra Hadžović Në zyrat e Forever Living Products të Bosnias porositë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387-55-211-784.

Njoftim i zyrës së FLP-s së Sarajevës

- Nga shtatori në shërbimin tonë është këshilltarja dhe specialistja mjekje nga Bosnia-Hercegovina Dr. Esmā Nisic, me të cilën mund të kontaktohem në numrin e telefonit: +387-62-367-545 gjatë ditëve të punës në orarin: 18:00 – 21:00.



NJOFTIMET E ZYRAVE TË KROACISË

- Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Grada Mainza 21., tel.: +385-1-390-9770., fax: +385-1-3909-771. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.
- Zyra e Splitit: 21000 Split, Križine 19. tel.: +385-21-459-262. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Dr. Molnár László

– Këshilltarja dhe specialistja jonë mjekje çdo të mërkurë mban konsultime në zyrën e Sarajevës në orën 17:00 – 19:30.
– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë krediti, atëherë shpenzimet e transportit paguhen nga distributori.

– Porosia telefonike bëhet në numrin +385-1-3909-773. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë, shpenzimet e transportit i paguan FLP-ja.
– Leksionet rreth marketingut dhe produkteve fillojnë çdo të hënë dhe të enjte në orën 18.00 në zyrën qendrore.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510
Dr. Eugenija Sojat Marendic: +385-915107070



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SLLOVENISË

- 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 5., tel: +386-1-562-3640. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.
- Adresa e magazinës së Lendavait: Kolodvorska 14., 9220 Lendava. tel: +386-2-575-1270. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Njoftojmë konsumatorët dhe distributorët tanë të nderuar që adresa e zyrës së Sarajevës është: AKIFA ŠEREMETA DO BR. 10, 71000 SARAJEVO, TELEFON: +387-33-760-650 ose 470-682, FAX: +387-33-760-651. Orari i hapjes: 9:00 – 16:30, të mërkurën: 12:00 – 20:00. Në të njëjtin orar bëhen edhe porositë në rrugë telefonike: Numri i telefonit: +387-33-760-650 në Sarajevë, dhe +387-55-211-784 në Bijelinë.

Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501

lu njoftojmë se nga shtatori mund të kontaktoni në rrugë telefonike me këshilltaren tonë mjekje specialiste, Dr. Esmā Nisic. Çdo ditë në orarin 18:00 – 21:00 i pret thirrjet tuaja në numrin e telefonit: +387-62-367-545. Këshilltarja jonë mjekje çdo të mërkurë në orarin 17:00 – 19:30 jep konsultim në zyrën e FLP-s të Sarajevës.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788
Dr. Canzek Olga: +386-41824163



NJOFTIMET E ZYRËS SË KOSOVËS

• Prishtinë, Rr. Zagrebi PN, tel.: +381-38-240-781. Drejtori i rajonit: Lulzim Tytnxhii

www.flpseeu.com FLP TV në internet

Programi nga 31 mars deri më 25 maj

10.00 Lajme	14.30 Success Day – Koncert i Fresh-it	21.30 World Rally 2007	03.35 Rruga – Zsolt Fekete
5.05 Nga bima deri tek produkti	14.50 Success Day – Istvan Halmi – Si të kesh një natë pa gjumë	Forever Pomesteen – Film prezantues produktesh	03.55 Pro6 - Film prezantues produktesh
10.20 Success Day – Dr. György Bakanek – Fëmijë të shëndetshëm	15.10 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007	21.35 Salloni Sonya – hapja	04.00 FLP – Plani Marketing
10.40 Nature's 18, Aloe2Go – Film prezantues produktesh	14.40 Film prezantues produktesh – Probiotic	21.40 Success Day – Dr. Adolf L. Kosa – Përse?	04.20 Success Day – Dr. Erika Tanacs Tombaczne – Përfjeto Momentin
10.45 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007	15.50 Michael Strachowitz – Ndërtim rrjeti me sukses në FLP	22.00 Active HA – Film prezantues produktesh	04.40 Success Day – Koncert i Magdolna Ruzsa-s Dita e kozmetikës Sonya – përmbledhje
11.20 FLP-ja prej 25 vitesh	17.50 Salloni Sonya – hapja	22.05 Success Day – Dr. Edit Revesz Siklosne – Ngarkohu me Pomesteen	05.10 World Rally 2007
11.35 Rruga – Zsolt Fekete	18.00 Lajme	22.30 Success Day – Koncert i Fresh-it	05.30 Forever Pomesteen - Film prezantues produktesh
11.55 Pro6 – Film prezantues produktesh	18.05 Nga bima deri tek produkti	22.50 Success Day – Istvan Halmi – Si të kesh një natë pa gjumë	05.35 Salloni Sonya – hapja
12.00 FLP – Plani Marketing	18.20 Success Day – Dr. György Bakanek – Fëmijë të shëndetshëm	23.10 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007	05.40 Success Day – Dr. Adolf L. Kosa – Përse?
12.20 Success Day – Dr. Erika Tanacs Tombaczne – Përfjeto Momentin	18.40 Nature's 18, Aloe2Go – Film prezantues produktesh	23.40 Film prezantues produktesh – Probiotic	06.00 Active HA – Film prezantues produktesh
12.40 Success Day – Koncert i Magdolna Ruzsa-s Dita e kozmetikës Sonya – përmbledhje	18.45 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007	00.50 Michael Strachowitz – Ndërtim rrjeti me sukses në FLP	06.05 Success Day – Dr. Edit Revesz Siklosne – Ngarkohu me Pomesteen
13.10 World Rally 2007	19.20 FLP-ja prej 25 vitesh	01.50 Salloni Sonya – hapja	06.30 Success Day – Koncert i Fresh-it
Forever Pomesteen – Film prezantues produktesh	19.35 Rruga – Zsolt Fekete	02.00 Lajme	06.50 Success Day – Istvan Halmi – Si të kesh një natë pa gjumë
13.35 Salloni Sonya – hapja	19.55 Pro6 – Film prezantues produktesh	02.20 Success Day – Dr. György Bakanek – Fëmijë të shëndetshëm	07.10 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007
13.40 Success Day – Dr. Adolf L. Kosa – Përse?	20.00 FLP – Plani Marketing	02.40 Nature's 18, Aloe2Go – Film prezantues produktesh	07.40 Film prezantues produktesh – Probiotic
14.00 Active HA – Film prezantues produktesh	20.20 Success Day – Dr. Erika Tanacs Tombaczne – Përfjeto Momentin	02.45 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007	08.50 Michael Strachowitz – Ndërtim rrjeti me sukses në FLP
14.05 Success Day – Dr. Edit Revesz Siklosne – Ngarkohu me Pomesteen	20.40 Success Day – Koncert i Magdolna Ruzsa-s Dita e kozmetikës Sonya – përmbledhje	03.20 FLP-ja prej 25 vitesh	09.50 Salloni Sonya – hapja



**IVANKA
VIDICEK**
managere



Kjo është një thirrje e bukur! Jam e bindur se Zig Ziglar mendonte pikërisht për bashkëpunonjësit e mi kur shkroi librin me titull "Takohemi në majë". Dhe ndoshta edhe për bashkëpunonjësit tuaj.

Në shumë fusha të jetës mund të përpiqemi të arrijmë majën. Për mua edhe kjo shfaqje në skenë përbën arritjen e një maje. Ndoshta edhe për ty përbën të njëjtën gjë. Shkon drejt shkallëve, nga hapi në hap ngjitesh lart në majë, nga ku shikon një pamje krejt tjetër. Nga niveli i sallës ndodhet më lartë ndriçimi dhe personi që luan muzikën.

Ndoshta do të pëlqej kjo pamje, ndoshta do të kesh emocione, ndoshta do të kesh frikë...

Por diçka do të ndryshojë në jetën tënde kur të tregosh përvojën tënde të parë me produktet. E meriton të jesh këtu lart. E meriton edhe kur të marrësh medaljen tënde të parë. Dhe gjithë medaljet e mëtejshme. Nëse do të drejtosh përvojat me produkte, kjo do të thotë që e meriton edhe këtë.

Kur dëshiron të ngjitesh në katin e dhjetë të një ndërtese mund të zgjedhësh ashensorin ose shkallët. Nëse zgjedh ashensorin, ngjitesh shpejt dhe gjatë rrugës nuk do ta kesh mendjen se kush e ndërtoi këtë ndërtesë të lartë apo në çfarë kati ndodhesh, por thjesht ngjitesh lart. Nëse zgjedh shkallët, rruga do të jetë më e vështirë, lodhesh, mezi merr frymë dhe mendon se kush ishte ai i çmendur që ndërtoi ndërtesë kaq të lartë, sa shumë punë ka investuar për ndërtimin dhe ndoshta edhe se sa të gëzuar ishin ndërtuesit kur mbaruan ndërtimin. E kryen punën e tyre dhe fituan me të shpërblimin e denjë.

Sipas mendimit tim dalin më mirë ata që zgjedhin shkallët (natyrisht nëse janë të aftë). Kjo është gjimnastikë dhe gjimnastika lshët shëndet, takohesh me fqinjët, bisedoni, ndihmoni njëri-tjetrin të ngrini ndonjë gjë, ankoheni pak, dhe kështu merr vesh se kush ka nevojë për ndihmë. Gëzohesh që e mposht edhe këtë pengesë. Në ashensor nuk mund ta ndjesh gjithë këtë, pasi arrin menjëherë në destinacion.

Çuditërisht gjithmonë me alpinistët, megjithëse unë vet nuk jam ngjitur asnjëherë në male, edhe unë arrita në

majë në mënyrën e sapopërmendur! Përshembull nëse dikush dëshiron të shikoj nga mali Triglav, mund ta bëjë duke zbritur në majë nga helikopteri, shijon pamjen dhe zbret pa asnjë përpjekje. Në këtë rast kënaqësia zgjat për një kohë të shkurtër.

Alpinistët nuk marrin shpërblim. Shpërblimi i tyre është arritja e majave të reja. Kanë shpenzime, për të cilat kërkojnë sponsor. Ngjiten së bashku, përballen me vështirësi, madje ndodh që edhe rrëzohen. Rrëshket një copë shkëmbi, këputet litari, plagoset partneri. Ndihmojnë njëri-tjetrin, i japin besim njëri-tjetrit, i gëzohen arritjes së çdo maje. I gëzohen çdo pjesë të ngjitur. Së bashku. Natyrisht ka nga ata që edhe panikohen dhe nervozohen, por gjithmonë ndodhet një dorë që jep ndihmë. Kur arrijnë në majë e harrojnë çdo të keqe, i harrojnë vështirësitë, dhembjet, gërvishtjet, të ftohtin, shiun... gjithçka të keqe. Rëndësi ka pikësynimi që kanë në zemër. Së bashku në majë.

Mendoje se kush e shijon më shumë suksesin, ai që zbret në majë nga helikopteri dhe shikon rrotull, apo alpinistët.

A s'iu kujtojnë këta alpinistë punën dhe veten tonë? Mua po? Në radhë të parë drejtuesi i ekspeditës i cili e ka arritur majën. E njeh rrugën dhe di t'i mposhtë pengesat. Si tek ne sponsori. Ai e ka përshkuar deri në fund rrugën dhe na drejton edhe ne për në majë.

E dimë se shkallët e planit marketing mund të ngjiten shpejtë dhe ngadalë. Nevojitet kohë më e shkurtër nëse zgjedhim ashensorin apo helikopterin.

Po, këta janë ata të cilët u ngjiten në mënyrë "artificiale" në pozicione të larta, kaluan një kohë të shkurtër në majë, por nuk i shohim më në radhët tona.

Gëzimin dhe dobinë e vërtetë materiale e përjetojnë ata që e bëjnë këtë rrugë me respekt dhe skuadër, duke u mbështetur tek të tjerët – tek sponsorët, linjat e sipërme dhe vëllazërore, ata që i ngjisin me këmbëngulje shkallët dhe majat.

TAKOHEMI NË MAJË

Ata nuk shqetësohen nga pretekstet e shumta, nga refuzimet dhe mosbesimi. Ata i përjetojnë pretekstet si rrëshqitja e shkëmbinjve gjatë ngjitjes drejt majës. Pastaj vjen një bashkëpunonjësi i ri i cili përbën një mbështetje të fortë për hapin e mëtejshëm, dhe e vazhdojnë së bashku rrugën drejt majës.

Sa herë i kemi dëgjuar fjalitë: këmbëngulje deri në sukses! Të mos kemi frikë nga përgjegjësia dhe disfata! Secili e drejton vetë jetën e tij! Mund të arrish gjithçka që dëshiron! Ti këtë nuk e dëshiron, dhe jo nuk e duron dot! Na duket me të vërtetë sikur gjithë kjo është e njohur për ne, na përsëriten fjalitë, madje edhe zogjtë këtë cicërojnë. Por prapë kështu mendojmë, kështu ndjejmë, kështu punojmë?

Bashkëpunonjësi im i dashur, përse të mos jesh ti ai që e shndërron ngjitjen e malit në një udhëtim të bukur? Dhe kur arrin në majë, shikon i

kënaqur pas dhe nuk do të vijë keq, nuk do të turpërohesh për premtimet e tua, pasi ato ishin të sinqerta, të realizueshme. Një udhëtim kur ndodh që mund të rëshqas ndonjë gurë, por do të kesh gjithmonë pranë një dorë që të ndihmon, do të kesh pranë konsumatorët e kënaqur, dhe si përfundim do të marrësh si shpërblim kënaqësi! Gjatë punës sonë udhëhiqemi nga qëllimi që të ndihmojmë vetveten dhe të tjerët, dhe të bëjmë para. Dhe kjo realizohet vetëm nëse sundojmë majat.

U përpoqa të bëj një paralelizëm ndërmjet përparimit në shkallët e marketingut dhe alpinizmit. Niveli i supervisorit përshembull është njëlloj me ngjitjen e Zumberacka gora-s. Arritja e nivelit të assistant managerit njëlloj me ngjitjen e Sljime-s. E kam zakon të them se unë me burrin tim u ngjitëm në Triglav. Tani na pret Kilimanxharo dhe Mount Everest. Dëshiroj të ngjitem në Mount Everest dhe mendoj se aty

më presin sponsorët e mi: Greta dhe Mirijan, Zsolt dhe Mirjana. Përse pikërisht ata? Sepse ata mbërritëm përpara meje në majën Triglav, në nivelin e managerit. Tani ata duhet të më drejtojnë që të arrij nivelin e senior managerit.

Po të duam do të arrijmë gjithmonë maja të reja. Bashkëpunonjësi i dashur, e rëndësishme është që të përpikësh me angazhim për arritjen e qëllimeve të tua. Unë kam nevojë për ty, sepse nuk dëshiroj të eci vetëm. Vetëm çdo rrugë është më e vështirë. Edhe ti ke nevojë për mua, pasi unë e njoh këtë rrugë. Dhe përpara arritjes së një maje tepër të lartë duhet ta ngjis edhe disa herë Triglav-in. Nevenka, Zvezdana, Ljubica, Marija... TI ke nevojë për drejtues.

Të dashur bashkëpunonjësi, detyra ime është që ta tregoj dhe të ndihmoj të arrish majën e zgjedhur nga ti, nivelin e managerit!



**ZSUZSANNA
UZONI**
senior manager



**Historia ime filloi
në një mënyrë të veçantë,
sepse mua në biznes
më solli një mace!**

Brenda 1 viti

Nga Supervisorin deri tek Senior Managerin

Zakonisht njeriun e ftojnë në një prezantim ose bisedë personale, por me mua ndodhi në mënyrë të tillë që çova tek veterineri macen time, e cila ishte plot me plagë, por s'po shërohej dot nga asnjë mjekim. Prandaj kushërija ime më rekomandoi veterineren e saj, **Dr. Zoltan Lukacs**-in. Ai me një të parë dhe me disa pyetje e përcaktoi se macja është alergjike ndaj konservave! Duhet t'ia ndryshoja ushqimin në mish të gjallë dhe peshk me vaj (për fatin e saj) dhe Zoli më dha disa kokrra të vogla, një krem në shishe dhe një spray.

Kur kremi mbaroi dhe doja t'i kërkoja më, u takova përsëri me **Dr. Zoltan Lukacs**-in dhe atëherë filluam të flisnim rreth produkteve.

Më bindi dhe bleva menjëherë gjithë paketën kundër tensionit të lartë të gjakut për bashkëshortin tim. Pra, e nënshkrova fletën e regjistrimit dhe kështu u bëra me një sponsor, megjithatë kjo mua atëherë nuk më interesonte shumë...

E fillova me vështirësi biznesin, pasi puna ime kryesore më zinte 9-10 orë në ditë, përveç saj udhëtoja tre të tjera, kështu që nuk është e vështirë ta imagjinoni se sa dëshirë kisha të punoja MË SHUMË! Por sponsori m'u lut të dërgoja tek ai disa njerëz të cilët ai do i ndihmonte. Dhe qeshëm me këtë, sepse përse po i çoj pikërisht tek një veteriner??? Kur pashë reagimet pozitive, atëherë edhe unë iu kushtova kësaj.

Kisha 2 motivime serioze, i pari ishte se punoja prej 14 vitesh në një

kompani multinationale dhe gjatë kësaj kohe nuk kisha arritur të bëja përpara. Prandaj kisha një dëshirë të madhe për ta treguar vetveten: jo për të tjerët, por për veten time – që edhe unë mund të arrij një nivel drejtuesi. Motivimi tjetër ishte dëshira për të ndihmuar të tjerët!

Kur filluam punën, sponsori im mbajti 8 mbrëmje tek unë, ku unë solla mysafirët, dhe në dhjetor të 2005-ës u bëra supervisorë! Unë nuk kisha shumë dëshirë të shkoja nëpër aktivitete, por me kërkesën e sponsorit shkova në Ditën e Suksesit Forever, dhe nuk desha të ngjitesha në skenë, por Zoli nuk e pranoi këtë. Dhe sot e falenderoj që më ngjiti aty, sepse përjetimi i atij vlerësimi është diçka e veçantë. Unë nuk kisha parë ndonjë firmë e cila i merrte kaq seriozisht vlerësimet, jo vetëm nga ana materiale, por edhe me rrahjen e shpatullave, e cila shpeshherë shumë njerëz i motivon më mirë se sa paraja. Edhe unë isha ndër këta njerëz!

Me një punë të vazhdueshme në maj të 2006-ës arrita nivelin e assistant managerit, me ndihmën e **Kriszta Szöllósi**-t dhe **Csaba Lay**-t. Me **Kriszta**-n punonim së bashku në kompaninë multinationale, kurse bashkëshorti i saj **Csaba** ishte në një situatë kur donte të fillonte një biznes privat. Mundësia e FLP-s e tërhoqi plotësisht çiftin racional ekonomist dhe **Csaba** e filloi këtë biznes si një punë të plotë.

Gjatë 8 muajve mbajtëm 31 mbrëmje, 67 biseda personale dhe pranimi i ftesave të mia ishte afërsisht 70 %. Është e vështirë ta

shprehësh atë që ndjeva kur pashë 120 pikët në informacionin e pikëve... Për mua ky ishte realizimi i 1 ëndrre. Kur u bëra manager, atëherë dëshira për ta treguar vetveten më iku plotësisht, pasi i tregova vetes që jam në gjendje ta arrij nivelin e drejtuesit, prandaj këtë e futa në xhep. Më mbeti dëshira për të ndihmuar dhe që atëherë ky më mbeti motivimi kryesor. Nga ai moment mua më interesonte vetëm që edhe **Kriszta Szöllösi dhe i shoqi** të bëhen managerë!

Për këtë nuk duhet të prisja shumë, sepse 1 muaj pas kualifikimit tim si manager u bëra manager me të drejtë autori, **Kriszta dhe i shoqi** për 3 muaj arritën nivelin e managerit! Kënaqësia më e madhe është kur shikon anëtarët e skuadrës tënde që qëndrojnë në skenë të gëzuar. Kjo është ajo që më mbush me energji dhe forcë për muaj të tëra.

Ndërkohë kolegja ima, **Eva Denes**, pa emrin tim në një broshurë dhe material informativ. Tani më pas e di se atëherë morra një nga respektet më të mëdha gjatë karrierës sime, pasi ajo m'u drejtua me dëshirën për të punuar me mua, ndërkohë që nuk

ishim miq të ngushtë, madje përveç simpatisë së sipërfaqshme nuk dinim asgjë rreth njëra-tjetrës, por ajo prapë u bashkua me mua. Filluam të punonim së bashku dhe nga dita në ditë dukej që ishim në të njëjtën mendje dhe që mendimet tona përforconin njëra-tjetrën! Kështu filloi karriera e **Evi Denes-it** e cila për ½ viti u bë manager. Bëhet fjalë për një njeri aq të shkëlqyer, rreth të cilit keni për të dëgjuar shumë edhe në të ardhmen. Në këtë biznes e kanë zakon të thonë që të kërkojmë bashkëpunonjës të cilët janë po aq të mirë ose më të mirë se ne, sepse me ata mund të punojmë mirë së bashku! Ky është një nga mesazhet e mia kryesore për ju, pasi përparimi im i shpejtë edhe falë faktit që kërkoja dhe gjeta njerëz të tillë! Bashkë me kualifikimin e **Evi-t** edhe unë arrita nivelin e senior managerit, por e rëndësishme është që mund t'i ndihmoj këta njerëz të shkëlqyer në realizimin e ëndrrave të tyre.

Për këtë, që ta arrija brenda 1 viti, më duhej një sponsor i cili më solli në botën e Forever-it dhe më mbështeti në këtë rrugë. Falenderoj për këtë **Dr. Zoltan Lukacs-in!** Më duhej shumë këmbëngulje, besim,

entuziazëm dhe vullnet, sepse pa këto s'ka biznes të fuqishëm Forever! Më duhej familja ime – burri dhe 2 fëmijët e mi, **Bernadett** dhe **Barnabas**, të cilëve iu mungoja çdo mbrëmje dhe pa ndihmën e të cilëve gjendja e familjes sonë do të shkatërrohej.

Dhe ajo që është më e rëndësishme: më duhej skuadra për të cilën jam shumë krenare, managerët e mi të dashur dhe të talentuar: **Kriszta Szöllösi, Csaba Lay dhe Eva Denes**, supervisorët e mi ambicioz: **Henrietta Boncser, Peter Nagy, Amarilla Redling, Katalin Szalay, Karoly Zseder**, dhe assistant supervisorët e zellshëm të cilët tani nuk mund t'i rreshtoj, madje s'kam as fat t'i njoh të gjithë, por të gjithë janë të rëndësishëm për mua! Iu falenderoj të gjithëve!

Dhe cila është rruga e të ardhmes? I premtoj të gjithëve që do t'i ndihmoj në biznesin Forever, dhe ata mund të kërkojnë gjithmonë ndihmë nga unë.

Mesazhi im në këtë biznes s'mund të jetë tjetër veçse: Help Forever, pra ndihmo përherë!





NANA
safir manager

Më vjen mirë që mund t'i tregoj ty këto dy sekrete. Që kur i zbulova i mbaj me vete ato. Edhe ti vepro kështu si unë, dhe pa dyshim viti 2007 do të jetë viti më i mirë për ty. Të dua Nana

Duhet ta keni mësuar që pa **përpjekje s'do të keni kurrë rezultat**. Por duhet edhe durim. Nëse dikush punon shumë dhe është më i duruar se sa Jobi, por prapë nuk arrin dot të ngrihet **mbi nivelin mesatar**, atëherë atij i mungojnë **planet e përpunuara mirë dhe qëllimet**. Pasi edhe një anije nuk e hedh spirancën pa patur një mol drejt të cilit merr drejtimin. Edhe ushtria nuk nis një luftë pa patur një strategji të sigurt me të cilën mund ta fitojë atë. Edhe një pemë ulliri nuk çel lule pa sjellë më pas prodhim. Jeta mund të jetohet edhe pa qëllime. Jeta është si një shfaqje teatri ku ka pak personazhe dhe shumë spektatorë. Ata që s'bëjnë gjë tjetër veçse shikojnë, janë shpërdorues. Ecin në Jetë pa ëndrra, qëllime dhe plane. Dhe as nuk e planifikojnë të ardhmen e tyre. Nuk duhet të na vijë keq për ta. **Ata vendosën vetë kështu kur nuk i shfrytëzuan mundësitë**. Nëse e shikojmë garën nga tribuna, nuk rrezikojmë asgjë. Kush nga ju mund të rrëzohet ose të dështojë pa provuar

MON AMUR

asgjë? Apo Ju jeni më mirë shikues? Ju këtu jeni shikues apo aktorë? Nëse jeni aktorë, atëherë s'keni për të humbur kurrë. Fitimtarët korrin gjithmonë frutat e suksesit dhe ata që deritani kanë pësuar shumë humbje, sot e kanë mësuar mësimin me të cilin nesër mund të ndryshojë rrjedhën e gjërave. Çfarë dëshironi të bëni me jetën tuaj? Mendojeni mirë dhe gjatë përpara se të merrni vendimin që pastaj iu bën të mundur gjithçka që dëshironi. Dëshironi të bëheni më të pasur? Dëshironi pushtet? Dëshironi të jetoni në një ambient të bukur? Dëshironi një shtëpi të madhe? Dëshironi të gjeni ekuilibrin shpirtëror? Dëshironi t'iu respektojnë? Dëshironi kushte më të mira jetese? Cilat janë qëllimet e mëdha në jetën tuaj? Duhet t'i gjeni. Duhet t'i rezervoni në thellësi të shpirtit dhe duhet t'i keni gjithmonë përpara syve. Por ndonjëherë kjo s'mjafton. Mos harroni se ndonjëherë Jeta është e padrejtë. Pasi edhe ata që kanë qëllime dhe punojnë shumë dhe me këmbëngulje për to s'kanë gjithmonë sukses. Prandaj nëse ju s'keni një nga këto tre gjëra të nevojshme (qëllime, këmbëngulje, punë e madhe), me shumë mundësi do të dështoni. Jepini vetes mundësinë që të keni sukses. Dhe nëse prapë dështoni, të paktën të dështoni në mënyrë të tillë që ju bëtë gjithçka në interes të asaj që kishit dëshirë të arrinit. **Duke filluar që sot përgatisni gjithmonë plan për të nesërmen. Shtrojini vetes pyetjen që a dëshiroj ta vazhdoj atë që po bëj tani. Vendosni që çfarë dëshironi të arrini. Pas kësaj, që t'i arrini qëllimet tuaja, planifikoni që çfarë duhet të bëni në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm. Dhe si përfundim realizojini ato.**

- Og Mandino

Pushteti i këmbënguljes

*Asnjëherë mos u dorëzo!
As atëherë kur çdo gjë të shkon keq,
siç ndodh ndonjëherë,
As atëherë kur të duket sikur
rruga është vetëm e pjerrët,
As atëherë kur të mbarojnë paratë dhe
të mbysin çeqet dhe borxhet,
As atëherë kur në vend të
qeshjes duhet të psherëtish,
As atëherë kur ke shumë halle,
Shploodhu nëse ke nevojë,
por asnjëherë mos u dorëzo,
Jeta është interesante dhe
plot me këthesa,
Siç e mëson secili prej nesh
me kalimin e kohës,
Dhe të gjithë takohemi
në këtë rrugë plot me dështime,
Por po të bashkohemi mund
të kenë të gjithë sukses,
Asnjëherë mos u dorëzo,
Sepse në të ardhmen me siguri
do të kesh sukses...
Suksesi në të vërtetë është
e anasjellta e dështimit,
Një qiell i kaltër që i përzë retë,
Dhe asnjëherë s'mund ta dish
se kur je afër qëllimit,
Sepse ndoshta je afër,
por prapë të duket i largët,
Por pikërisht atëherë
nuk duhet të dorëzohesh,
kur gjërat marrin për keq!*

Edgar A Guest

*I mirëpresim të gjithë
punonjësit tanë që duan të
mësojnë dhe pushojnë*

Sonya
Color Collection

*në Qendrën
Mësimore dhe të
Shërbimit Sonya.*



Orari i hapjes në **Magazinën tonë**
(1183 Budapest, rr. Nefelejcs 9–11) **e hënë, e martë, e enjte:** 14:00–20:00,
në **Qendrën tonë** (1067 Budapest, rr. Szondi 34, kati II) **e mërkurë, e premte:** 13:00– 17:00.
Punonjësit e qendrës së re, masazhatorët Ildiko Hrnicsjar dhe Csilla Fülöp
dhe specialistja e kozmetikës Ildiko Meszaros (06-20/457-1155).
Ata që duan të zbukurohen dhe të mësojnë në qendrën mësimore
priten vazhdimisht nga **Kata Ungar!**

Shtypi

Botuese: Kompania Forever Living Products, Hungari.

Redaktoi: FLP Magyarorszá g Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Redaktori kryesor: Dr. Miliesz Sándor

Redaktor: Kismárton Valéria, Veress Angéla, Rókás Sándor

Përgatitja për shtypje: Tipofill 2002 kft.

Grafika: Teszár Richárd, Buzássy Gábor

Shtypi: Veszprémi Nyomda Zrt. U përgatit në 49 250 kopje

Për përmbytjen e artikujve shkruarit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!

Përkthyes, redaktues: shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko

– serb: Tóth-Kása Ottília, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana



Sonya's[®]
Color Collection